VENDIM
Nr. 941, datë 28.12.2016

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.1139, DATË 24.11.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË AUTOMJETEVE DHE TË SHOFERËVE NË DISPOZICION TË MINISTRIVE DHE TË INSTITUCIONEVE QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 113, të ligjit nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendimi nr.1139, datë 24.11.2009, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore", i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore që, brenda datës 15 janar 2017, të dorëzojnë në Ministrinë e Financave të dhënat në nivel ministrie/institucioni qendror të pavarur për:

- numrin aktual të mjeteve të transportit në dispozicion;
- numrin e punonjësve në funksionin "shofer", miratuar në strukturën organike aktuale.

3. Ngarkohet Ministria e Financave që të iniciojë vendimin përkatës për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama